



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 227, Datë 06.09.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERNI SOLAR”
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.09.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1510/4 prot., datë 02.09.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ERNI SOLAR” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ERNI SOLAR” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1429 prot., datë 23.08.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga Centrali Fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2,2 MW.
- Pavarësisht se shoqëria ka paraqitur kërkesën për t’u licencuar për 2,2 MW, në çdo dokument, miratim apo leje, kapaciteti i përcaktuar është 2 MW, ashtu si dhe në kontratën me MIE-n, ku specifikohet se shoqëria nuk mund të operojë me kapacitet më të madh se 2 MW. Gjithashtu, edhe pagesa që ka bërë subjekti për llogari të ERE-s, në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, përkon me kapacitetin 2 MW. Në këto rrethana aplikimi i shoqërisë do të shqyrtohet për kapacitetin e instaluar 2 MW.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe lejet nga institucionet respektive. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pika 1, gërmat “a” dhe “b”, nenit 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “e” dhe “f”, nenit 9, pika 3, gërmat “a” dhe “d”, nenit 9, pika 4.4.3, gërmat “a”, “c” dhe “d”, nenit 9, pika 4.4.4, gërma “b” si dhe nenit 9, pika 4.4.5, gërmat “a” dhe “b”.
- Dokumentacioni i munguar apo i plotësuar pjesërisht është si vijon:

Neni 9, pika 1, gërma “c”: Shoqëria duhet të plotësojë deklaratën për njohjen me kuadrin ligjor dhe angazhimin për zbatimin e tij.

Neni 9, pika 2, gërma “d”: Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, si dhe vërtetimin përkatës të Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Korçë, për shoqërinë “ERNI SOLAR” sh.p.k.

Neni 9, pika 2, gërma “g”: Shoqëria duhet të depozitojë sqarimin përkatës të “ERNI SOLAR” sh.p.k. në lidhje me sipërfaqen totale të zonës së projektit, në rast se ka ndonjë gabim të mundshëm në referencat e kësaj prone që do të shfrytëzojë shoqëria për ndërtimin dhe shfrytëzimin e projektit të centralit fotovoltaik. Gjithashtu, shoqëria duhet të depozitojë informacion mbi saktësimin e koordinatave të pronësisë në shkresën e Bashkisë Devoll, në lidhje me referimin që i bëhet numrit të pasurisë së pronës dhe nr. të repertorit të kontratës së qirasë që shoqëria “RTS” sh.p.k. ka lidhur me Bashkinë Devoll.

Neni 9, pika 3, gërma “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE bilancin financiar të vitit 2019, referuar muajve të krijimit të saj.

Neni 9, pika 3, gërma “c”: Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka vijuar me nënshkrimin e ndonjë kontrate kredie me bankën për të siguruar investimin për 80% të vlerës që do të investohet nga banka dhe nëse po, ta dokumentojë në ERE me sqarimet përkatëse mbi qëllimin e përdorimit të fondeve të marra hua nga banka. Po ashtu, në zbatim të nenit 8, pika 3, vërtetimi mbi gjendjen e llogarisë bankare duhet të depozitohet i lëshuar jo më herët se 1 muaj përpara paraqitjes së aplikimit, në mënyrë që të përlllogaritet nëse shuma përkatëse mbulon 20% të vlerës së mbetur të investimit.

Neni 9, pika 4.4.1: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE të dhënat përkatëse për centralin fotovoltaik në lidhje me *orët e punës në një vit, numri i njëjësive gjeneruese, rendimentin dhe vitin e ndërtimit.*

Neni 9, pika 4.4.2.: Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat përkatëse teknike në lidhje me *prodhuesin e transformarotit, kapacitetin, gjatësinë e linjës dhe kapacitetin transmetues.*

Neni 9, pika 4.4.4, gërma “b” : Shoqërisia duhet të depozitojë në ERE grafikun e përditësuar, i cili parashikohet dhe në Aneksin 2 të kontratës me MIE-n.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Meqënëse Studimi i Fizibilitetit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik 2 MW parashikon se jetëgjatësia e burimit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ERNI SOLAR” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW për një afat 25-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI